



## KËSHILLI I BASHKISË K O R Ç Ë

VENDIM  
Nr. 122 datë 02.12.2010

### Për dhënien e ndihmës familjes të dëmtuar nga zjarri.

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sek. i Shërbimeve Komunitare dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike, "Për dhënien e ndihmës financiare për familjen e dëmtuar", bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.206 datë 26.03.1998. i ndryshuar, "Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e demeve në raste fatkeqësish" Ligjin nr.8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe Fuksionimin e Qeverisjes Vendore" neni 32, gërma dh. në ligjin nr.9936dt. 26.062008. "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" në ligjin nr 10190 dt. 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010, Udhëzimin MF nr 1 dt. 21.01.2010 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2010" si dhe në VKB nr 20 dt 25.03.2010 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2010"

### VENDOSI

1. Të ndihmohet familja e qytetarit Pandeli Rado e cila u dëmtua nga zjarri i rënë në banesën nr 16. e ndodhur në lagjen nr. 3, Rruga "Mihal Grameno".Familja ditën e aksidentit ka qënë e përbërë 4 (Katër) persona, e konfirmuar kjo nga Zyra e Gjëndjes Civile. Masa e ndihmës për dëmin në pajisje dhe orendi do të jetë si me poshtë:

4 persona x 20 000 = **80 000 lek**

2. Ky fond do të përballohet nga fondi i emergjencave civile të miratuar në buxhetin e Bashkisë për vitin 2010 me strukturë buxhetore:

00 04980 05 Art. 6061041 Vlerë 80 000 lek

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës Sek. Shërbimeve Komunitare dhe Emergj.Civile dhe Drejtoria Juridike.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

K R Y E T A R I

Gjergji PENDAVINJI

